



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1043/3 Prot

Tiranë, më 26.06.2019

V E N D I M

Nr. 77, datë 26. 06. 2019

Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në lidhje me procedurën e plotësimit të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, nëpërmjet shpalljeve të konkurrimit me kod #2201, #2203, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi proçedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të akteve dhe materialit paraprak të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit paraprak të informacionit të marrë nga kërkesa e punonjësës
*****.

VËREJ SE:

Nëpërmjet kërkesës së regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr.1043 prot, datë 21.05.2019, kërkuesja ***** ka ngritur pretendimin se bazuar në ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, ka aplikuar pranë DAP-Departamentit të Administratës Publike për pozicionet e shpallura nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Nisur nga përmbajtja e aktit të shpalljes së konkurrimit, evidentohet që veç kriterëve të përgjithshme e kërkesave të posaçme që lidhen me përmbajtjen e pozicionit të punës që kandidatet duhet të plotësojnë për tu kualifikuar për fazën e dytë të konkurrimit Njësia Përgjegjëse (Drejtoria e Burimeve Njerëzore) e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, ka shtuar dhe kriterin që kandidatët “...të jenë deri në moshën 35 vjeç”.

Ne rastin konkret Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se përcaktimi i kriterit të moshës si më sipër vjen në kundërshtim, si me parimet e administrimit të shërbimit civil në tërësi, ashtu dhe me parimet e rekrutimit në veçanti.

Në këtë përfundim arrihet duke pasur parasysh përmbajtjen e nenit 5, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, i cili përcakton shprehimisht se administrimi i shërbimit civil udhëhiqet nga ligji dhe bazohet në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit dhe meritës.

Po kështu në nenin 20, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar parashikohen parimet e pranimit në shërbimin civil, ku parashikohet në mënyrë të shprehur se: “Pranimi në shërbimin civil bazohet në parimet e shanseve të barabarta meritës, aftësive profesionale, e mosdiskriminimit, dhe kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës, transparent, e të drejtë”.

Në këto rrethana përcaktimi i kufirit përjashtues të moshës, në rastin e konkurrenave me kod #2201,#2203 apo edhe në raste të tjera të ngjashme, i vendosin kandidatët në përgjithësi dhe konkurrenten ***** në veçanti, në kushte diskriminuese për shkak të moshës. Ky aspekt përbën element të paligjshmërisë të aktit të shpalljes së konkurimit e për këtë arsye në mbështetje të neneve 109/d dhe 113, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në aktin e shpalljes së këtyre procedurave për pranim në shërbimin civil, duhet të shfuqizohet kriteri i moshës dhe akti i njësisë përgjegjëse për skualifikimin e konkurrentes *****.

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga Njësia Përgjegjëse dhe njësia e burimeve njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme e Doganave, të marrin masa të menjëhershme, për anulimin e procedurës së konkurimit nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, për pozicionet me kod #2201, #2203; heqjen e kriterit të moshës dhe të veprohet për rishpalljen e kësaj procedure, duke respektuar parimet e administrimit në shërbimin civil dhe të pranimit në shërbimin civil.
2. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat 5 ditë, nga marrja dijani e vendimit.

3. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
4. Në rast të mos respektimit të vendimit, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrimin dhe në zbatim të përcaktimit të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës, për moszbatimin e masës së përcaktuar në dispozitivin e vendimit.

Të njoftohet për këtë vendim Departamenti i Administratës Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, dhe shtetasja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha